3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rast]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga
Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik
“.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën
përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë
personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e
prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti
Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e
prokurimit me objekt _____, është i pamiratuara dhe
pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara
nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti: “Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore – kopshte”

Skicimet, parametrat teknikë etj.

Parametrat teknikë, sasitë, njësitë e matjes dhe llojet e ndërhyrjeve përcaktohen në dokumentet teknike bashkëlidhur kësaj shtojce:

1. Preventivi pa çmime;
2. Specifikimet teknike të materialeve dhe të proceseve të realizimit;
3. Grafiku i realizimit të shërbimeve;
4. Termat e referencës.

Këto dokumente janë pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit dhe duhet të lexohen së bashku. Në rast paqartësie, operatori ekonomik duhet të kërkojë sqarim brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik.

Nuk parashikohen skica ose vizatime të veçanta, përveç rasteve kur ato përfshihen shprehimisht në dokumentacionin teknik bashkëlidhur.

Specifikimi i materialeve

Materialet dhe pajisjet që do të përdoren duhet:

- të jenë të reja dhe të papërdorura më parë;
- të përmbushin parametrat minimalë të specifikimeve teknike;
- të jenë të përshtatshme për funksionin dhe vendin ku do të përdoren;
- të jenë në përputhje me standardet shqiptare ose evropiane të zbatueshme;
- të shoqërohen me dokumentacion teknik dhe dokumente konformiteti, vetëm kur këto janë të zbatueshme për produktin përkatës;
- të jenë të një cilësie që garanton sigurinë, funksionalitetin, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e ndërhyrjeve.

Çdo referencë ndaj një standardi, tipi, materiali ose zgjidhjeje të caktuar teknike duhet të kuptohet e shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalent”. Operatori ekonomik mund të propozojë materiale ose pajisje ekuivalente, me kusht që të provojë përmbushjen e parametrave minimalë teknikë.

Përpara përdorimit ose montimit, kontraktori duhet t'i paraqesë strukturës përgjegjëse për ndjekjen e kontratës dokumentacionin teknik përfundimtar të materialeve dhe pajisjeve. Materialet që nuk përmbushin specifikimet teknike nuk do të pranohen.

Përshkrimi i kërkesave të realizimit të shërbimeve

Shërbimi duhet të realizohet në përputhje me preventivin, specifikimet teknike, termat e referencës, grafikun e realizimit dhe kërkesat e kontratës.

Kontraktori duhet:

- të realizojë të gjitha ndërhyrjet sipas sasive dhe kërkesave teknike të përcaktuara;
- të organizojë proceset sipas grafikut 3-mujor;
- të sigurojë personelin, mjetet dhe pajisjet e nevojshme;
- të marrë masa për mbrojtjen e objekteve, personelit dhe përdoruesve;
- të respektojë legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen e mjedisit;
- të largojë dhe administrojë mbetjet e krijuara;
- të riparojë me shpenzimet e veta çdo ndërhyrje që nuk përmbush specifikimet;
- të koordinojë proceset me strukturën përgjegjëse për ndjekjen e kontratës;
- të dorëzojë dokumentacionin teknik, certifikatat, raportet e provave dhe garancitë, kur janë të aplikueshme.

Afati i realizimit është 3 (tre) muaj nga data e përcaktuar në kontratë.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor
vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen:

Realizimi i shërbimit me objekt “Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore – kopshte”, që përfshin ndërhyrjet e përcaktuara në preventivin pa çmime, specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Afati i ekzekutimit:

3 (tre) muaj, duke filluar nga data e përcaktuar në kontratë ose nga data e dorëzimit të objekteve për realizimin e shërbimit, sipas grafikut të ekzekutimit.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Punime dheu	Gërmime dhe transport dheu/materialesh sipas preventivit	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji I
Prishje	Prishje të suvasë së brendshme dhe largim i materialeve të krijuara	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji I–II
Dyer dhe dritare	Furnizim dhe vendosje dyersh dhe dritaresh sipas preventivit	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji II–III
Punime shtresash	Shtrim me pllaka mermeri, porcelani, gres dhe shtresë betoni	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji II–III
Hidroizolim dhe çati	Llustrim çimentoje, hidroizolim, termoizolim, ulluqe dhe veshje llamarine	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji I

Instalime hidrosanitare dhe ngrohje	Furnizim dhe vendosje pajisjesh sanitare, tubacionesh, rakorderish dhe boilerësh	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji II
Punime tavani dhe suvatimi	Termoizolim fasade, suvatim muresh dhe soletash	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji II–III
Instalime për ndriçim	Furnizim dhe vendosje tubacionesh elektrike, prizash, çelësash dhe ndriçuesish	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji I
Shtresa në territorin e ndërtesave	Furnizim dhe shtrim parketi laminat	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji II
Punime bojatisjeje	Lyerje me bojë hidroplastike sipas specifikimeve teknike	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji III
Punime shtresash	Realizim i shtresës me zhavorr lumi	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji II
Zëra me analiza jashtë liste	Tuba PEX, tavane gipsi, pllaka betoni, parkim biçikletash, ndriçues LED, ventilim dhe aspirim	Sipas sasive të preventivit pa çmime	Objektet arsimore – kopshte, në territorin e Bashkisë Shkodër	Muaji III

Sasitë dhe njësitë e matjes përcaktohen në preventivin pa çmime, ndërsa kërkesat e realizimit përcaktohen në specifikimet teknike dhe termat e referencës. Dokumentet e mësipërme janë pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit. Kontraktori duhet të koordinojë grafikun e detajuar me strukturën përgjegjëse për ndjekjen e kontratës, pa ndryshuar afatin e përgjithshëm prej 3 (tre) muajsh.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve

Objekti i kontratës është realizimi i shërbimit “Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore – kopshite”, në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.

Qëllimi i shërbimit është mirëmbajtja, riparimi dhe rikthimi i funksionalitetit të elementeve ekzistuese të objekteve arsimore, me qëllim garantimin e kushteve të përshtatshme të përdorimit, sigurisë, higjienës dhe funksionimit normal të tyre.

Shërbimi përfshin ndërhyrje riparuese ndërtimore, rifiniture, hidroizolimi, suvatimi, bojatisjeje, instalime hidrosanitare dhe elektrike, zëvendësim dyersh dhe dritaresh, shtrim dyshemesh, tavane gipsi, ndriçim, ventilim dhe ndërhyrje të tjera të përcaktuara në preventivin pa çmime dhe specifikimet teknike.

Ndërhyrjet realizohen në objekte ekzistuese dhe nuk synojnë ndërtimin e objekteve të reja ose ndryshimin e destinacionit të godinave.

Detyrat

Kontraktori duhet:

- të realizojë të gjitha shërbimet dhe ndërhyrjet sipas preventivit pa çmime, specifikimeve teknike, grafikut dhe kushteve të kontratës;
- të sigurojë personelin, materialet, mjetet dhe pajisjet e nevojshme;
- të verifikojë gjendjen e vendit përpara fillimit të çdo ndërhyrjeje;
- të koordinojë fillimin dhe zhvillimin e shërbimeve me strukturën përgjegjëse për ndjekjen e kontratës;
- të përdorë materiale të reja, të papërdorura dhe në përputhje me parametrat teknikë;
- të paraqesë për miratim dokumentacionin teknik dhe të konformitetit të materialeve, kur është i aplikueshëm;
- të mbrojë elementet ekzistuese të objekteve që nuk janë pjesë e ndërhyrjeve;
- të organizojë dhe sinjalizojë zonën e punës, duke shmangur rrezikun për fëmijët, personelin dhe përdoruesit e objekteve;
- të respektojë kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen e mjedisit;
- të largojë dhe administrojë mbetjet e krijuara gjatë realizimit të shërbimeve;
- të riparojë, me shpenzimet e veta, çdo ndërhyrje që nuk përmbush specifikimet teknike;
- të mbajë dhe të dorëzojë dokumentacionin e realizimit, matjet, procesverbalet, raportet dhe dokumentet e tjera të kërkuara;
- të përfundojë shërbimet brenda afatit kontraktor prej 3 (tre) muajsh.

Kontraktori nuk duhet të kryejë ndërhyrje jashtë preventivit ose të ndryshojë materialet, sasinë dhe zgjidhjet teknike pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor.

Shpërndarja

Shërbimet do të realizohen sipas nevojave të evidentuara në objektet arsimore – kopshte dhe sipas rendit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me preventivin dhe grafikun 3-mujor.

Proceset do të shpërndahen sipas këtij organizimi të përgjithshëm:

- **Muaji I:** punime dheu, prishje, hidroizolim dhe instalime për ndriçim;
- **Muaji II:** vijimi i prishjeve, dyer dhe dritare, shtresa, instalime hidrosanitare, suvatime dhe ndërhyrje në territor;
- **Muaji III:** përfundimi i dyerve, dritareve, shtresave dhe suvatimeve, bojatisje dhe zërat me analiza jashtë liste.

Grafiku i detajuar i realizimit duhet të koordinohet me strukturën përgjegjëse për ndjekjen e kontratës, pa ndryshuar afatin e përgjithshëm.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve

Shërbimet do të realizohen në objektet arsimore – kopshte, në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër, sipas objekteve dhe ndërhyrjeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Dorëzimi do të bëhet për çdo objekt ose grup ndërhyrjesh të përfunduara, nëpërmjet verifikimit në vend dhe hartimit të dokumentacionit përkatës nga kontraktori dhe struktura përgjegjëse për ndjekjen e kontratës.

Shërbimet konsiderohen të dorëzuara vetëm pasi:

- të jenë realizuar sipas preventivit dhe specifikimeve teknike;
- të jenë kryer matjet dhe verifikimet përkatëse;
- të jenë korrigjuar mangësitë e konstatuara;
- të jetë pastruar zona e ndërhyrjes dhe të jenë larguar mbetjet;
- të jetë nënshkruar procesverbali përkatës i marrjes në dorëzim.

Dokumentacioni teknik, procesverbalet, matjet, raportet dhe garancitë e materialeve, kur janë të aplikueshme, dorëzohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një (1) nga vitet e kërkuara duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit, konkretisht **3 333**

314,29 (tre milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e katërbëdhjetë presje njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën një (1) nga vitet financiare të kërkuara.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin/vërtetimet e lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse, që provojnë shlyerjen e të gjitha detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, si dhe të kësteve të maturuara të vitit 2026, për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 20% e fondit limit, konkretisht **1 666 657,15 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë presje pesëmbëdhjetë) lekë.**

Për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

a) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik**, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, objekti dhe afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat**, fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të vlefshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent, e cila të përfshijë minimalisht kategoritë e mëposhtme:

- **N.P-1, Niveli A** – Punime gërmimi në tokë;
- **N.S-2, Niveli A** – Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi dhe mirëmbajtja e tyre;
- **N.S-4, Niveli A** – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifinitura me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami;
- **N.S-14, Niveli A** – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV etj.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të disponojë kategoritë e licencës profesionale që mbulojnë pjesën e punimeve që merr përsipër të realizojë, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik.

Inxhinierët duhet të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik dhe të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig) për të paktën muajin e fundit përpara publikimit të njoftimit të kontratës.

Inxhinieri i Ndërtimit duhet të jetë i përfshirë në licencën profesionale të operatorit ekonomik dhe do të përcaktohet si Drejtues Teknik i kontratës. Administratori i operatorit ekonomik dhe Drejtuesi Teknik duhet të deklarojnë se ky i fundit do të jetë i disponueshëm gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

Kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Ofertuesi i kualifikuar, i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë për secilin inxhinier:

- diplomën;
- kontratën individuale të punës;
- dokumentacionin E-Sig për muajin e fundit.

Për Drejtuesin Teknik duhet të paraqiten gjithashtu deklarata e administratorit për përcaktimin e tij dhe deklarata përkatëse e disponueshmërisë.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë fuqinë punëtore, stafin zbatues dhe personelin inxhinierik të nevojshëm për realizimin e kontratës. Numri i punonjësve të siguruar për të paktën muajin e fundit përpara datës së publikimit të njoftimit të kontratës duhet të jetë jo më pak se 17 (shtatëmbëdhjetë), nga të cilët 2 (dy) punonjës janë personeli inxhinierik i kërkuar në pikën 2.3.3 dhe 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës përbëjnë stafin zbatues. Përveç tyre, operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) manovrator, i cili mund të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik ose të sigurohet së bashku me ekskavatorin nëpërmjet kontratës së qirasë/shërbimit. Personeli organizohet minimalisht sipas profileve të mëposhtme:

Profili	Numri minimal
Punëtor pa kualifikim	1
Manovrator	1 (i punësuar ose i siguruar me ekskavatorin)
Marangoz	2
Pllakashtrues	1
Hidroizolues	1
Hidraulik	1
Punëtor ndërtimi	6
Elektracist	1
Bojaxhi	1
Punëtor gipsi	1

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë:

Për personelin e kualifikuar

(elektracist, hidraulik, marangoz, pllakashtrues, hidroizolues, bojaxhi dhe punëtor gipsi):

- Kontratën individuale të punës;

- Dëshmi kualifikimi profesional, certifikatë ose diplomë të lëshuar nga institucione arsimore, qendra të formimit profesional ose institucione të autorizuar/licencuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokumentacion që provon regjistrimin në listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig) për muajin e fundit.

Për punëtorët e ndërtimit dhe punëtorin pa kualifikim:

- Kontratën individuale të punës;
- Dokumentacion që provon regjistrimin në listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig) për muajin e fundit.

Për manovratorin, sipas mënyrës së disponimit:

- Kontratën individuale të punës dhe dokumentacionin E-Sig për muajin e fundit, kur manovratori është i punësuar pranë operatorit ekonomik; ose
- Kontratën e qirasë/shërbimit, të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës, kur manovratori sigurohet së bashku me ekskavatorin;
- Lejen e drejtimit ose dëshminë e kualifikimit për drejtimin e makinerive të punës, sipas legjislacionit në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë në përdorim, nëpërmjet kontratës së qirasë ose një forme tjetër të ligjshme disponimi, minimalisht mjetet dhe pajisjet teknike të mëposhtme për realizimin e kontratës:

Nr.	Mjeti/Pajisja	Sasia minimale
1	Mjet transporti vetëshkarkues me kapacitet të përshtatshëm për transportin e materialeve dhe largimin e mbetjeve	1 copë
2	Ekskavator me goma	1 copë
3	Pompë suvatimi	1 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë dokumentacionin provues.

Për mjetet e regjistruara në regjistrat publikë:

- Lejen e qarkullimit;
- Certifikatën e kontrollit teknik (kur është e aplikueshme);
- Policën e sigurimit të vlefshme;
- Certifikatën për transport mallrash brenda vendit, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Për pajisjet që nuk regjistrohen në regjistrat publikë:

- Dokument që provon pronësinë (faturë tatimore, akt zhdoganimi ose dokument tjetër ekuivalent).

Për mjetet ose pajisjet e marra me qira:

- Kontratën e qirasë ose kontratën tjetër që provon të drejtën e përdorimit, e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës;
- Dokumentacionin e pronësisë ose të regjistrimit të mjetit/pajisjes.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme të sistemeve të menaxhimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) **SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalent** – Sistemi i menaxhimit të cilësisë;

b) **SSH EN ISO 14001:2026 ose ekuivalent** – Sistemi i menaxhimit mjedisor;

c) **SSH EN ISO 45001:2023 ose ekuivalent** – Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Për SSH EN ISO 14001 do të pranohet edhe certifikata sipas SSH EN ISO 14001:2015, për aq kohë sa ajo vazhdon të jetë e vlefshme gjatë periudhës zyrtare të tranzicionit, ose certifikatë/dokument ekuivalent.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, certifikatat duhet të paraqiten nga anëtari ose anëtarët që do të realizojnë shërbimet me të cilat lidhet fusha e certifikimit, në përputhje me përqindjen dhe natyrën e shërbimeve të marra përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, së bashku me ofertën, dokumentacionin teknik për materialet dhe pajisjet kryesore të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Për secilin produkt duhet të paraqitet skeda ose katalogu teknik i prodhuesit, ku të identifikohen prodhuesi, emërtimi/modeli ose kodi dhe karakteristikat teknike që provojnë përputhjen me specifikimet teknike.

Sipas natyrës së produktit dhe vetëm kur janë të aplikueshme, duhet të paraqitet një ose disa nga dokumentet e mëposhtme:

- deklarata e performancës;
- deklarata e konformitetit;
- dokumentacioni për markimin CE;
- raport testimi;
- certifikatë cilësie;
- dokument teknik ekuivalent.

Autoriteti Kontraktor pranon produkte, standarde dhe dokumente ekuivalente, me kusht që operatori ekonomik të provojë përmbushjen e parametrave minimalë të specifikimeve teknike.

Materiali/pajisja	Njësia
Dyer të brendshme tamburate, të rimesuara	m ²
Dritare alumini me xham të dyfishtë	m ²
Dyer alumini ose PVC me xham të dyfishtë, sipas preventivit	m ²

Pllaka gres	m ²
Material hidroizolues me bazë çimentoje, bikomponent (A+B)	m ²
Polistiren kompakt për termoizolim	m ²
Membranë bituminoze hidroizoluese	m ²
Lavaman porcelani	copë
WC allafrënga	copë
Boiler	copë
Sistem termoizolimi fasade, tip kapotë	m ²
Ndriçues plafonier	copë
Ndriçues emergjence/evakuimi	copë
Parket laminat	m ²
Bojë hidroplastike	m ²
Pllaka dhe profile për tavan të varur prej gipsi	m ²
Ndriçues LED plafonier	copë

Për sistemin kapotë :

Klasifikimi i reagimit ndaj zjarrit duhet të provohet me raport klasifikimi, raport testimi, deklaratë performance ose dokument ekuivalent, sipas SSH EN 13501-1 ose standardit ekuivalent dhe sipas klasës minimale të përcaktuar në specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:
etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
